



NDRYSHIMET KLIMATIKE DHE ROLI I FËMIJËVE SI AKTORË NDRYSHIMI



Save the Children



Suedi
Sverige

NDRYSHIMET KLIMATIKE DHE ROLI I FEMIJEVE SI AKTORE NDRYSHIMI

Ekspert

Alken Myftiu

Tiranë, 2020

Botimi i këtij materiali informues për fëmijë u mundësua nga Save the Children

Save the Children është organizatë kryesuese në botë dhe e pavarur për fëmijë. Ne besojmë se çdo fëmijë meriton një të ardhme të mirë. Në botë dhe në Shqipëri, Ne ndihmojmë fëmijët të kenë një fillim të mbarë në jetë, mundësi për të mësuar dhe mbrojtje ndaj çdo rreziku. Ne bëjmë më të mirën për fëmijët - çdo ditë dhe në kohë krize –për të sjellë ndryshime në jetën e tyre dhe të ardhmen e përbashkët.

Ky material publikohet në kuadër të projektit “Nga Fëmijët për Fëmijët”, i financuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar dhe zbatuar nga Save the Children në bashkëpunim me Zyrën e Avokatit të Popullit dhe Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.

© Të gjitha të drejtat të rezervuara. Përmbajtja e këtij materiali mund të përdoret apo kopjohet lirisht prej specialistëve të fushës, por jo për qëllime fitimprurëse, me kusht që çdo riprodhim të shoqërohet me njohjen e organizatave, të përmendura më lart, si burim.

Këndvështrimet e autorëve të këtij botimi jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjet e Save the Children.

Përmbajtja

1. Hyrje
2. Çfarë janë ndryshimet klimatike?
3. Çfarë është dioksidi i karbonit?
4. Si kanë ndryshuar temperaturat e tokës ndër vite?
5. Cila është lidhja mes përqendrimit të gazeve serrë në atmosferë dhe temperaturës mesatare të planetit?
6. Pse është shqetësuese rritja e temperaturave?
7. Çfarë mund të bëjnë fëmijët si aktorë të ndryshimit për të patur një rol të rëndësishëm në drejtim të ndërgjegjësimit qytetar për mjedisin?
8. Cilat janë hapat që kanë ndërmarrë shtetet e zhvilluara për të luftuar ndryshimet klimatike?
9. Disa sugjerime për veprime që mund të bëhen nga individët për parandalimin e ndryshimeve klimatike.
10. “Efekti Greta”

Hyrje

Përshëndetje fëmijë,

Çështja e ndryshimeve klimatike, gjithnjë e më shumë është kthyer në një çështje parësore për shkak të rëndësisë së tyre të veçantë. Një nga problemet më të mëdha me të cilin po ballafaqohet bota sot është ndryshimi klimatik, një dukuri e cila shpesh po kalon e pavërejtur nga konfliktet dhe krizat politike në botë. Vëmendja tërhiqet vetëm atëherë kur dëgojmë për lajme për uraganë dhe vërshime të cilat shpesh marrin edhe jetë njerëzish. Çdo ditë e më tepër jemi dëshmitarë të ndryshimeve të motit, të cilat e prekin në masë të madhe shëndetin tonë. Ngrohja globale që shkaktohet nga ndryshimet klimatike sjell një rritje të valëve të nxehtësisë dhe ne e dimë se çfarë do të thotë kjo për njerëzit me sëmundje të zemrës, me astmë dhe sëmundje të tjera.

Pak dihet ose pranohet se aktiviteti njerëzor ka një rol të madh në shkatimin e këtyre fatkeqësive, së pari me prodhimin e dioksid karbonit dhe efekti serrë që kanë ndikim në ngrohjen e atmosferës. Efekti më i dukshëm i kësaj dukurie është rritja e nivelit të detit, që rezulton me përmbytje në zonat e ulta bregdetare dhe si e tillë mund të jetë një kërcënim i vërtetë për shumë vende.

Ky material informues do t'ju ndihmojë të kuptoni më mirë ndryshimet klimatike dhe çfarë mund të bëjnë fëmijët si aktorë të ndryshimit për të patur një rol të rëndësishëm në drejtim të ndërgjegjësimit qytetar për mjedisin.

Ndryshimet Klimatike

Çfarë janë ndryshimet klimatike?

Ndryshimet klimatike janë ndryshimet periodike të klimës së Tokës, të shkaktuara nga ndryshime në atmosferë dhe ndërveprimi i atmosferës me faktorë gjeologjikë, kimikë, biologjikë dhe gjeografikë

1.


Ndryshimet klimatike ne i diskutojmë, në më të shumtën e kohës, si ngrohje globale, por, është e nevojshme që t'i vendosim në një kontekst më të gjerë të historisë së Tokës.

Mosha e Tokës mendohet të jetë 4.5 miliardë vite dhe ndryshimet klimatike janë pjesë e kësaj historie. Me shumë gjasë, ju keni dëgjuar për lidhjen mes ngrohjes globale apo ndryshimeve klimatike, rritjes së temperaturave dhe rritjes së përqendrimit të dioksidit të karbonit në atmosferë.

Dioksidi i karbonit bën pjesë në të ashtuquajturit gaze serrë. E dini se çfarë janë? A mund të më thotë dikush se çfarë janë?

Besoj e keni parasysh se çfarë janë serrat? Ngrehina me xham (ose plastmas të tejdukshëm) që përdoren për rritjen e bimëve. Xhami lejon dritën e diellit të hyjë brenda dhe nuk lejon rrezatimin në formën e nxehtësisë të dalë jashtë.

Në mënyrë të ngjashme, rrezatimi diellor mbërrin në Tokë, në formën e dritës. Një pjesë e energjisë që vjen me dritën përthithet nga toka, një pjesë pasqyrohet. Një pjesë e asaj që




përthithet nga toka çlirohet në formën e nxehtësisë. Gazet serrë, që gjenden në atmosferë, kanë një cilësi shumë të veçantë: ata lejojnë energjinë e dritës të kalojë dhe ndalojnë energjinë e nxehtësisë. Është sikur Toka të jetë e mbështjellë me batanije ose është brenda një serre. Për këtë shkak, Toka është më e ngrohtë se ç'do të ishte pa gazet serrë në atmosferë. Dhe me shumë gjasë, pa gazet serrë dhe me planetin më të ftohtë, mund të mos kishte kushte për të mbështetur jetën në Tokë. Është vlerësuar se gazet serrë e ngrohin Tokën me afro 30° Celsius, Pa këtë dukuri, temperatura e Tokës do të ishte diku pranë -18° Celsius.

2.

Më i njohuri nga gazet serrë është dioksidi i karbonit. Por nuk është i vetëm: metani, oksidet e azotit dhe klor-flor-karbonet (CFC) janë gaze të tjera serrë të fuqishëm. Shkenca ka arritur në përfundimin se janë të paktën 46 gaze serrë në atmosferë.

Le të shohim si ka ndryshuar temperatura e planetit gjatë historisë së tij. Grafiku i mëposhtëm tregon temperaturën e tokës, në 800 mijë vitet e fundit. Shohim se temperatura e Tokës ka pasur ndryshime të shumta përgjatë dhjetra mijra viteve. Pikat më të ulëta në grafik tregojnë ndryshimin negativ të temperaturës dhe përputhen me periudhat e akullnajave, ndërsa pikat më të larta të grafikut tregojnë ato që quhen periudha ndërmjet akullnajave. Më e fundit periudhë akullnajash ka qenë afro 10 mijë vjet më parë dhe që atëherë temperaturat e Tokës kanë qenë në ngritje.




3.

Le të shohim pak lidhjen e ndryshimit të temperaturave të tokës me përqendrimin e gazeve serrë në atmosferë. Shkencëtarët kanë studiuar flluskat e ajrit të kapura në shtresat e akullit të lashtë dhe kanë gjetur përbërjen e ajrit në faza të ndryshme të kohës.

Në tre grafikët e mëposhtëm paraqiten ndryshimet e përqendrimit të dioksidit të karbonit, metanit dhe në fund të ndryshimit të temperaturës.

A mund të më thoni s çfarë vini re në të tre këta grafikë?

Të dhënat nga stacioni Vostok, në Antarktidë




4.

Pra duket qartë se ka një lidhje të drejtpërdrejtë mes përqendrimit të gazeve serrë në atmosferë dhe temperaturës mesatare të planetit.

Po meqenëse kjo qenka një dukuri natyrore, pse u dashka që të shqetësohemi me ngritjen aktuale të temperaturave?

Le të shohim një grafik tjetër tani, që tregon ndryshimin e temperaturës në kaluarën e afërt. Fillon nga gjysma e dytë e shekullit 19. Siç mund ta shihni në këto afro 150 vjet dallohet një rritje e temperaturës globale. Grafiku tregon ndryshimin e temperaturës globale ndaj temperaturës mesatare të së njëjtës periudhë. Deri nga viti 1940, temperaturat kanë qenë

më të ulëta se mesatarja, ndërsa pas atij viti, dukshëm, më të larta nga mesatarja. Dhe në gjithë periudhën, duket se ka një rritje të përgjithshme të temperaturave, që dëshmon për ngrohjen globale në 100-200 vitet e fundit.




Source: 1 <https://data.giss.nasa.gov/>

Por ka dhe një të dhënë tjetër që provon ngrohjen globale: në 100 vitet e fundit, niveli i deteve është rritur me afërsisht 10-25 cm. Për dy shkaqe: nga bymimi i ujit nga ngrohja dhe nga shkrirja e mbulesës së akullit.

Në 200 vitet e fundit, burimi kryesor i gazeve serrë është përdorimi i lëndëve djegëse fosile.

E pra, sa më shumë lëndë djegëse fosile përdorim në njerëzit, aq më shumë karbon i mbërthyer në molekulat e tyre nën tokë, çlirohet në atmosferë, duke shtuar përqendrimin e gazeve serrë



Source: 2 U.S. Department of Energy/CDIAC

dhe, për rrjedhojë, edhe të temperaturës globale.


Por nuk mbaron këtu. Përveç lëndëve degjese fosile, shkaqe të tjera nga veprimtaria njerëzore janë shpyllëzimet masive (për zhvillimin e sipërfaqeve të reja urbane), tjetërsimi i sipërfaqeve natyrore.

5.

Por pse është shqetësuese rritja e temperaturave?

Këtë dukuri e bën më të rëndësishme shpejtësia me të cilën po ndodh kjo rritje temperaturash. Skenarët e ndryshëm që janë hartuar sesi do të shtjellohet kjo dukuri janë disi shumë shqetësuese:

- Për dy dhjetëvjeçarët e ardhshëm, një seri skenarësh projektojnë një ngrohje me rreth $0,2^{\circ}\text{C}$ /dhjetëvjeçar.
- Nëse përqendrimi i gazeve serrë mbahet në të njëjtin nivel me atë të vitit 2000, pritet një ngrohje me rreth $0,1^{\circ}\text{C}$ /dhjetëvjeçar.
- Rritja e përqendrimeve të tyre mbi këto nivele pritet të shkaktojë ndikime më të mëdha në sistemin global të klimës, është shumë e mundshme që ngrohja globale të jetë më e ndjeshme se në shekullin 20.
- Nëse nuk veprohet, në vitin 2035, mund të arrihet dyfishi i gazeve serrë në atmosferë, krahasuar me periudhën paraindustriale, duke na çuar drejt një ngritje të temperaturës mesatare globale me 2°C .



- Në terma afatgjatë, probabiliteti është >50% që temperatura të rritet me >5°C. Kjo rritje do të ishte e frikshme: që nga mbarimi i periudhës së fundit të Akullnajave, temperatura mesatare ka ndryshuar vetëm 5°C. Kjo do të sjellë ndryshime drastike në gjeografinë e gjallesave dhe sidomos atë njerëzore – ku jetojnë dhe si jetojnë njerëzit.

Do të keni dëgjuar, lexuar për dukuri ekstreme të motit: zjarret e sivjetshme në Australi, Kaliforni, etj. Përmbajtje masive në indi, Bangladesh; thatësira ekstreme në Afrikë, Europë, etj.

Po në Shqipëri? Mund të përmendë dikush shembuj të dukurive ekstreme të motit?

Ecuria kohore e përmbajtjeve dhe përmbajtjeve të shpejta për periudhën nga 1946 deri në 2013. Vihet re se numri i ngjarjeve po rritet në mënyrë të qëndrueshme, ka patur një lloj kulmi në vitin 2010, por dhe vitet në vijim nuk kanë mbetur pas. Në 20 vitet e fundit ka ndodhur të paktën një përmbajtje çdo vit; kemi patur periudha thatësirash, zjarre në verë, periudha ngricash ekstreme. Stinët janë shkrirë pothuaj me njëra tjetrën: vjeshta dhe pranvera janë më të shkurtra dhe me më pak reshje, vera është bërë më e nxehtë dhe më e thatë. Apo jo?

6.

Gjithsesi, gjendja nuk është kaq e zymtë. Si gjithnjë, ka rrugëdalje! Një sfidë kaq e madhe është njëkohësisht një ditë të re në historinë e njerëzimit, një mundësi e re për t'u zhvilluar. Edhe për arsyen se nuk mund të ketë rrugë tjetër!

Ngrohja globale është një sfidë për gjithë njerëzimin – nga të paktat që kërkon domosdoshmërisht bashkëpunim efektiv nga të gjitha vendet.




NASA - Lindja e diellit si duket nga hapësira

Siç e përmendëm, shkak kryesor për rritjen e shkarkimeve të gazeve serrë është përdorimi i lëndëve djegëse fosile – zgjidhja i bie të jetë ulja deri te mospërdorimi i lëndëve djegëse fosile për nevojat e njerëzve.

Nga studimet më të fundit del se çmimi i mosveprimit ndaj ndryshimeve të klimës është shumë më i lartë se çmimi i masave/veprimeve për t'i frenuar ato.

7.

Vendet e botës kanë ndërmarrë hapa të rëndësishëm, për të luftuar së bashku ndryshimet klimatike



Njerëzimi ka një burim virtualisht të pashtershëm energjie: dielli dërgon në Tokë, në një orë, një sasi energjie të mjaftueshme për plotësuar nevojat e gjithë njerëzimit për energji për një vit të tërë. Po t'i shtosh kësaj edhe energjinë që mund të sigurohet nga era, atëherë ekuacioni duket i thjeshtë. Megjithatë, është pak më i ndërlikuar: është e nevojshme që këto burime energjie të rinovueshme të konkurrojnë ekonomikisht me burime të lira (por të ndyra) të energjisë si nafta dhe qymyri.

Kjo po ndodh. Instalimet për të prodhuar energji nga dielli janë shtuar në mënyrë eksponenciale në dhjetëvjeçarin e fundit. Kostot e prodhimit të energjisë nga dielli kanë rënë në mënyrë drastike dhe teknologjia po zhvillohet me ritme të atilla që mund ta bëjnë edhe më të lirë dhe më të përhapur.

Disa nga teknologjitë që mund të ndihmojnë në uljen e shkarkimeve të gazeve serrë:

- Prodhim i automjeteve eficientë dhe atyre tërësisht elektrike
- Ndërtim i ndërtesave eficientë: reduktim me 25% i shkarkimeve në të gjitha ndërtesat
- “kapja” dhe depozitimi i karbonit nga një numër i madh i centraleve me qymyr apo gaz natyror.
- Rritja e përdorimit të energjisë bërthamore.
- Rritja e prodhimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme si dielli dhe era.
- Përgjysmimi i shpyllëzimeve dhe dyfishimi i pyjeve të reja
- Ruajtja e tokës: përdorimi i strategjive të menaxhimit të karbonit në fermat bujqësore.

“

Kërcënimi më i madh për planetin tonë është besimi se dikush tjetër do ta shpëtojë atë

Robert Swan”

8.

Por përveç niveleve të politikave dhe zhvillimeve teknologjike, ka shumë hapësirë për secilin nga ne si individë për të vepruar.

A mund të listoni një numër veprimesh që mund të bëhen nga individët, familjet, bashkësitë e vogla të njerëzve?

Kurseni energjinë – në cilëndo mënyrë të mundshme.

Ja për shembull, kompjuterat Apple. Sipas vetëdeklarimit të kompanisë një laptop MacBook Pro 13”, në gjendje qetësie, harxhon 3.25 Ë, ndërsa një iMac 21,5” harxhon 27,8 Ë. Me fjalë të tjera, laptopi është 7 herë më eficient. Nëse është e mundur, bleni një laptop, në vend të kompjuterit të tavolinës.

Ndriçimi LED është gjithashtu një mënyrë e thjeshtë për të kursyer energji në shtëpi, mjediset e përbashkëta në pallate, shkollë, ndriçimin publik, etj. Krahësimi me ndriçimin që përdor nxehjen e materialit për të prodhuar dritë është mjaft i qartë, për harxhimin e energjisë dhe cilësinë e ndriçimit.

Përdorni më pak automjetin

Makinat janë një nga shkarkuesit më të mëdhenj të dioksidit të karbonit. Sa për ilustrim, në SHBA, automjetet kontribuojnë me një të pestën e shkarkimeve të CO₂. Natyrisht mospërdorimi i plotë i makinave është më e mira, por më praktike është një gjithsecili ta përdorë makinën sa më pak të jetë e mundur. Alternativat janë ecja, lëvizja me bicikletë, përdorimi i transportit publik. Bicikletat elektrike, skuterat elektrikë janë një alternativë e re që po fiton shumë terren, sidomos për atë që quhet lëvizje për kilometrin e fundit.

Kur bëni dush, mbajeni ujin sa më të ftohtë

Bën mirë për trupin (rrit qarkullimin e gjakut, forcon sistemin imunitar dhe nxit metabolizmin), plus që bën shumë mirë për mjedisin (harxhon më pak energji për ngrohjen e ujit, që do të thotë më pak CO₂ në atmosferë).

Hani më pak mish të kuq

Është pak e vështirë kur bëhet fjalë për ushqimin. Njerëzit kanë nevojë të hanë dhe, për më tepër, popullsia e botës rritet vazhdimisht. Ne presim pyje për tokë bujqësore apo kullota. Për të prodhuar mish viçi, fermerëve u duhet 28 herë më shumë sipërfaqe toke se prodhimi i mishit të derrit apo pulës, 11 herë më shumë ujë, sipas një studimi në vitin 2014. Prodhimi i mishit të kuq është pesë herë më i dëmshëm për klimën se mishit i bardhë dhe 11 herë më i dëmshëm se prodhimi i patateve, orizit dhe grurit.

Mbill një pemë... ose dy

Në një studim optimist thuhet se nëse mbjellim mjaftueshëm pemë në gjithë sipërfaqen e papërdorur të tokë, mund të zerojmë efektin për ndryshimin e klimës në 20 vjet. Megjithatë, duket se vetëm mbjellja e pemëve nuk mund ta zgjidhë problemin. Sidoqoftë mbjelljet ndihmojnë: një pemë përthith 14 kg CO₂ në vit dhe afro një ton në 40 vite jetë. Çdo kg CO₂ vlen! Nëse nuk mbjell dot, ndoshta, në vend të Google, përdorni makinën e kërkimit në internet “ecosia.org”, që mbjellin një pemë për çdo 45 kërkime të tuat në internet.

Bli produkte vendase dhe produkte të sezonit

Për të siguruar fruta dhe perime jashtë sezonit, dy janë mënyrat: importi ose bujqësia intensive (shumë ujë dhe shumë energji për të prodhuar jashtë sezonit). Ndaj është e rëndësishme që njerëzit të jenë të ndërgjegjshëm në blerjet e tyre. Blerja e produkteve vendase, që

Industria e veshjeve

Industria e veshjeve prodhon 10% të të gjitha shkarkimeve të karbonit nga veprimtaria njerëzore, (më shumë se transporti detar dhe ajror së bashku); renditet e dyta për nivelin e harxhimit të ujit dhe ndot oqeanet me mikroplastikë.

prodhohen pranë vendbanimit (pa patur nevojë për shumë transport) është e dobishme për ekonominë, por edhe për klimën dhe mjedisin.

Kurseni ujin

Uji i pijshëm dhe i pastër po bëhet gjithnjë e më i rrallë për shumë vende në botë. Përdorni më pak ujë për t'u larë (dush të shpejtë në vend të përdorimit të vaskës plot me ujë; lani rrobat me ujë sa më të ftohtë që është e mundur, për të kursyer energji.

Votoni (shtyni ata që mund të votojnë) dhe/ose protestoni

Thelbi këtu është që fëmijët dhe të rinjtë duhet të bëhen bashkë e të kërkojnë ndryshimet që duan.

9.

Efekti “Greta”

“Të Premtet për të Ardhmen”

“Grevë nga Shkolla, për Klimën”

“...**Më keni vjedhur ëndrrat dhe fëmijërinë time**, me fjalët tuaja boshe... Jemi në fillim të një **zhdukjeje masive** të gjallesave, ndërsa ju flisni vetëm për para, dhe **përralla për rritjen e përhershme ekonomike**. Si guxoni?!...”

“Make the world Greta Again”



**Askush nuk është i vogël
për të sjellë ndryshimin**



Save the Children

Rruga: Mihal Popi, Ndërtesa 7, ish Pallatet 1 Maji, (Vila Lami);
PO Box 8185, Tiranë - Shqipëri; Tel: +355 4 2261840/ 4 2261929

E-mail: info.albania@savethechildren.org

[https:// albania.savethechildren.net](https://albania.savethechildren.net)



Savethechildrenal



SaveChildrenAlb



savethechildreninalbania